



**PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSB)
IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)**

Komuna / Opština: Drenas Data / Datum: 19.12.2022

Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini: 6

Takim i rregullt / Redovni sastanak Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak

Numri i anëtarëve të KKSB-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: 17

A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSB-së?

Da li su predstavnici nevećinskej zajednice, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku?

Po / Da

Jo / Ne

Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice

A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSB-së?

Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovaao sastanku?

Po / Da

Jo / Ne

Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë
Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju

A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo nënkyetari?

Da li je sastankom predsedavaao Gradonačelnik ili Zamenik?

Po / Da

Jo / Ne

Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu:

Në mbledhje u diskutuan këto pika të rendit të ditës:

1. Procesverbal i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 21.10.2022: <https://kk.rks-gov.net/glogoc/ep-content/uploads/sites/10/2022/11/Procesverbali-i-KKSB-se-se-dates-21.10.2022.pdf>
2. Raport lidhur me vërvshimet gjatë muajit Nëntor në Komunën e Drenasit;
3. Raport lidhur rastet e dhunës në familje- Tryeza për parandalimin e dhunës në kuadër të fushatës '16 aktivizëm kundër dhunës me bazë gjinore';
4. Të ndryshme

Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:

Konkluzionet / Zaključci:

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) ka mbajtur mbledhjen e rregullt dhe të fundit për këtë vit me datë 19 dhjetor 2022. Mbledhjen e kryesoi nënkyretari i Komunës së Drenasit, Arben Shala, dhe koordinatorja Laureta Thaqi. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e KKSBB-së apo përfaqësuesit e tyre dhe përfaqësues nga LMT e KFOR-it Sloven si dhe përfaqësues të UNMIK-ut njëherësh.

Pikat e rendit të ditës të cilat u diskutuan ishin:

- Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSBB-së të mbajtur me datë 21.10.2022: <https://kk.rks-gov.net/glllogoc/ep-content/uploads/sites/10/2022/11/Procesverbali-i-KKSBB-se-se-dates-21.10.2022.pdf>
- Raport lidhur me vërsimet gjatë muajit Nëntor në Komunën e Drenasit;
- Raport lidhur rastet e dhunës në familje- Tryeza për parandalimin e dhunës në kuadër të fushatës ‘16 aktivizëm kundër dhunës me bazë gjinore’;
- Të ndryshme

Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSBB-së të mbajtur më 21.10.2022 u miratua unanimisht, pa ndonjë vërejtje nga antarët e KKSBB-së.

Për pikën e dytë, drejtoresha e Drejtorisë Komunale për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krapi, paraqiti një përbledhje të vërsimeve për muajin Nëntor dhe intervenimet që kanë bërë sipas kërkesave të qytetarëve. Po ashtu, është formuar komisioni për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore, të cilat pas përfundimit të vlerësimit do të procedohen në nivelin qendror për kompenzim. Paraprakisht vlerësimi duhet të kaloj në Kuvend, dhe pastaj në nivel qendror i cili do të verifikoj se a është bërë vlerësimi sipas rregullores për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera, dhe pastaj do të merret vendimi për kompensim. Ne total vlerësimi 108.983 euro, 43.120 euro biznese, 59.6302 euro ekonomi familjare dhe 6.232.81 euro bujqësi.

Ndërsa, për rastet e dhunës në familje, znj.Nazmije Rrukiqi hetuese e këtyre rasteve në stacionin policor në Drenas, informoi për statistikat e dhunës mbi bazë gjinore duke theksuar se vitet e fundit është rritur numri i rasteve, njëherit edhe vetëdijesimi se këto raste duhet të raportohen në organet përkatëse.

Në këtë pikë u theksua se ky fenomen në rritje është shqetësues dhe se gratë janë viktimi në shumë raste që keqtrajtohen fizikisht dhe psiqikisht qoftë nga bashkëshortet apo anëtarët e tjerë të familjes. Duke u bazuar në statistikat në tri vitet e fundit, Covid-19 ka ndikuar në shtimin e rasteve të dhunës në familje.

Në vitin 2020 janë raportuar 71 raste të dhunës në familje, ku 58 prej tyre viktima gra, dhe 18 viktima burra. Prej viktimate gra, 8 të strehuara në qendrën për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve, dhe 24 urdhra mbrojtës nga gjykata janë lëshuar.

Në vitin 2021 janë raportuar 53 raste, 45 viktima gra ,14 viktima burra si dhe Gjykata ka shqiptuar 19 aktvendime për urdhra për mbrojtje.

Në vitin 2022, janë raportuar gjithsej 65 raste, 45 gra viktima dhe 19 burra viktima. Të dyshuara 8 gra, 61 burra. 26 viktima kanë kërkuar trajtim mjekësor, 6 nga ato janë dërguar në strehimore. Me vendim janë ndaluar për 48 ore 24 burra dhe 1 grua. 26 vendime për urdhër mbrojtës janë lëshuar, ku aktiv janë 18 urdhra për mbrojtje dhe që viktimat jetojnë në komunën e Drenasit. Nga këto 18 urdhra mbrojtës, 3 raste janë më të ndjeshëm që vizitohen dhe kontaktohen shpesh përmes telefonit.


Te kjo pikë, nënkyetari Shala theksoi si komunë mundohen të përkrahin strehimoret dhe për këtë vit është ndarë një shumë të caktuar duke theksuar se do të vazhdojnë të ndihmojnë edhe gjatë vitetave në vijim varësisht nga mundësitet buxhetore.

Të ndryshme: U parashtrua një pyetje lidhur me projektet e infrastrukturës rrugore, ku Nënkyetari Shala theksoi se ka pasur disa vonesa për shkak se shumë investime që kanë qenë në proces, pra kontrata dy vjeçare, OE-të kanë hezituar ti vazhdojnë për shkak të inflacionit të çmimeve si dhe OSHP që për një kohë ka qenë jo-funksionale.

Procesverbali u përpilua nga koordinatori i KKSBS-së:

Izveštaj pripremio Koordinator OOBZ: Laureta Thaqi
(emri, mbiemri dhe nënshkrimi / ime, prezime i potpis)

Procesverbali aprovohet nga Kryetari:



Ramiz Lladrovci

Izveštaj odobrava Gradonačelnik:

Data e aprovimit / Datum odobravanja: 17.01.2023

Rekomandimet:

- Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL nen 11 pika 6;
- Prosesverbali përpilohet nga koordinatori i KKSBS-së në Komunën përkatëse;
- Prosesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën: mph.ds@rks-gov.net
- Prosesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën: Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net

Prosesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKSBS-së.